

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	VIDEO/ Humbi ndjenjat gjatë anestezisë për një ndërhyrje estetike, influencerja 27-vjeçare ndërron jetë disa ditë më vonë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/video-humbi-ndjenjat-gjate-anestezise-per-nje-nderh-yrje-estetike-influ-i585997
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 10:52:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 10:46:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ba483cef52330b4413eeb1645f6a59b9b4b9dd76fd64611b55e79df4a5173a4e
TEKSTI	bdef28a36c93a8fa0b54e6241b251a53f175835211ea3a0b43a4f553b06a2024
PAMJA	b7fabccce86812aa7a7b1c8c1250d850f284a378ca60825fad8b1e57a4beb2816

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e15f522cd707e04b92e2d0c3a543f73ee3b4a7d63cf43d35fc5fa1c8dc244daa
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	fa5011856be057622e11e3b7b9503371417a521d23e6e858a13f19aee6db6a1d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e15f522cd707e04b92e2d0c3a543f73ee3b4a7d63cf43d35fc5fa1c8dc244daa>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English



IE "Koha e tij ka mbaruar" - Anceiotti konfirmon fundin e Neymarit me Brazilin: Ai nuk dëshiron të kthehet, tani fokusi është te lojtarët e rinj VIDEO/ Humbi ndjenjat gjatë a fundit

VIDEO/ Humbi ndjenjat gjatë anestezisë për një ndërhyrje estetike, influencerja 27-vjeçare ndërron jetë disa ditë më vonë



14 Shtator 2026, 12:46Lifestyle TEMA



Influencerja finlandeze Olivia Oras ka ndërruar jetë në moshën 27-vjeçare, disa ditë pasi humbi ndjenjat gjatë përgatitjes për një ndërhyrje estetike në një klinikë private në Helsinki.

Sipas mediave të huaja, Oras po përgatitej t'i nënshtrohej një liposuksioni kur humbi ndjenjat pas administrimit të anestezisë. Ajo u transportua në Spitalin Universitar të Helsinkit, por ndërroi jetë disa ditë më vonë, më 3 shtator.

Familjarët e saj kanë kërkuar hetim mbi rrethanat e vdekjes, ndërsa policia finlandeze ka nisur një hetim për dyshime për shkaktim të rëndë të vdekjes nga pakujdesia.

Rasti ka marrë një tjetër zhvillim pasi autoritetet kontrolluan klinikën Plastic Surgery Center në Helsinki. Sipas The Sun, hetuesit konstatuan shqetësime serioze lidhur me sigurinë e pacientëve dhe më 9 shtator u urdhërua pezullimi i aktivitetit të klinikës.

Policia nuk ka bërë të ditur nëse ka persona të arrestuar apo të ndaluar në lidhje me rastin. Gjithashtu, ende nuk është përcaktuar publikisht nëse ndonjë gabim mjekësor ka shkaktuar vdekjen e 27-vjeçares.

Sipas raportimeve të The Sun, familjarët e Oras besojnë se vdekja e saj mund të ketë ardhur si pasojë e një procedure estetike që nuk shkoj sipas planit. Hetimi vijon për të përcaktuar saktësisht se çfarë ndodhi në klinikë.

Olivia Oras ishte bërë e njohur në Finlandë që në adoleshencë, pasi krijoi një ndjekës të konsiderueshëm në Instagram. Ajo u shfaq gjithashtu në dokumentarin e vitit 2016, "The Perfect Selfie", që trajtonte jetën e saj dhe marrëdhënien me rrjetet sociale.

Vdekja e saj ka shkaktuar reagime të shumta, ndërsa rasti vijon të hetohet nga autoritetet finlandeze.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[12 ditë në spital, moderatori shqiptar tregon betejën e vështirë shëndetësore: “Jeta është e çmuar”](#)

11:53 Lifestyle , 1 koment

VIDEO/ Pas rikthimit në Britani, Meghan Markle publikon pamjet e para me Princ Harry dhe fëmijët, momentet familjare bëjnë xhiron e rrjetit

10:44 Lifestyle

[FOTOT/ Disa në muajin e mjaltit, disa single, ja ku i bënë arratisjet e fundit të pushimeve vajzat e showbizit](#)

10:27 Lifestyle / 1 koment

Beteja ligjore mes Dua Lipës dhe Samsung hyn në një fazë të re, kompania kërkon rrëzimin e padisë prej 15 milionë dollarësh

09:34 Lifestyle / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.